



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 233, Datë 02.11.2018**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR DISA AMENDIME PËR PROPOZIMIN E TË  
GJITHË OST-VE MBI “UDHËZUESIN PËR KËRKESAT ORGANIZATIVE,  
ROLET DHE PËRGJEGJËSITË NË LIDHJE ME SHKËMBIMIN E TË  
DHËNAVE” (KORP)**

Në mbështetje të neneve 7; 16; 56 dhe 63 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e energjisë elektrike”; i ndryshuar, nenit 40, pika 6të Rregullores së Komisionit të BE 2017/1485, “Mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike (SO GL)”, (Security of Operation Guideline, or Commission Regulation (EU) 2017/1485 of 2 August 2017 establishing a guideline on electricity transmission system operation / Rregullorja e Komisionit të (BE) 2017/1485, ose Udhëzuesi mbi Sigurinë Operacionale).; nenit 26 të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, si dhe duke konsideruar se Operatori i Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a, është anëtare me të drejta të plota e ENTSO-E, Bordi i ERE-s, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për miratimin e disa amendimeve për propozimin e të gjithë OST –ve “Mbi Udhëzuesin për Kërkesat organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave “ (KORP),

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 159, datë 09.07.2018, miratoi “Udhëzuesin për kërkesat organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave” (KORP).
- Në vijim të këtij miratimi, OST sh.a me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 674 Prot., datë 22.10.2018, ka dërguar për miratim, amendimet për propozimin e të gjithë OST-ve mbi “Udhëzuesin për kërkesat organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave” (KORP).

- Pas shqyrtimit nga ENTSO-E në cilësinë e hartuesit të KORP, në datën 9 tetor 2018, u krye votimi në lidhje me këto amendime i cili rezultoi në favor të miratimit të tyre.
- KORP është propozim i të gjitha OST-ve të ENTSO-E për kërkesat themelore organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave, draftuar në përputhje me nenin 40, pika 6 të Rregullores së Komisionit të BE 2017/1485 “Mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike SO GL” (*Security of Operation Guideline, or Commission Regulation (EU) 2017/1485 of 2 August 2017 establishing a guideline on electricity transmission system operation / Rregullorja e Komisionit të (BE) 2017/1485, ose Udhëzuesi mbi Sigurinë Operacionale*).
- Versioni i amenduar dhe i miratuar i këtij akti është publikuar dhe në faqen zyrtare të ENTSO-E, ku OST sh.a është anëtare me të drejta të plota.
- Amendimet përkërkesat organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave” (KORP), janë bashkëlidhur këtij vendimi dhe konsistojnë kryesisht në një sistemim sintaksor dhe leksik më të mirë të strukturës së këtij Udhëzuesi, me qëllim kuptimin më të mirë nga ana e palëve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e disaamendimeve për propozimin e të gjithë OST-ve mbi “Udhëzuesin për Kërkesat Organizative, Rolet dhe Përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave (KORP). (Drafti me ndryshime bashkëlidhur këtij vendimi)
2. Versioni në gjuhën e origjinës (Anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët të versionit Shqip.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit do të njoftojë palët e interesuara.

**KRYETARI**

**PETRIT AHMETI**